

**VENDIM**  
**Nr. 686, datë 16.8.2013**

**PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA PARCELAVE NDËRTIMORE NË  
FAVOR TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, të shkronjës “ç” të nenit 4 të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar, dhe paragrafit të tretë të nenit 175 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kalimit në pronësi të poseduesve të objekteve informale të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për:

a) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana (1), 48 (dyzet e tetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 16 130,9 (gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë presje nëntë) m<sup>2</sup>;

b) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana (2) (Kamëz), 6 (gjashtë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 280 (dy mijë e dyqind e tetëdhjetë) m<sup>2</sup>;

c) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana (2) (Paskuqan), 5 (pesë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 333 (dy mijë e treqind e tridhjetë e tre) m<sup>2</sup>;

ç) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana (2) (Vorë), 12 (dymbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 5 762 (pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy) m<sup>2</sup>;

d) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana (2) (Farkë), 1 (një) parcelë ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 621 (gjashtëqind e njëzet e një) m<sup>2</sup>;

dh) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana (3), 39 (tridhjetë e nëntë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 388,74 (dy mijë e treqind e tetëdhjetë e tetë presje shtatëdhjetë e katër) m<sup>2</sup>;

e) Drejtorinë e ALUIZNI-t Kavajë, 1 (një) parcelë ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 233,8 (dyqind e tridhjetë e tre presje tetë) m<sup>2</sup>;

ë) Drejtorinë e ALUIZNI-t Durrës, 56 (pesëdhjetë e gjashtë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 25 162 (njëzet e pesë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy) m<sup>2</sup>;

f) Drejtorinë e ALUIZNI-t Vlorë (1), 23 (njëzet e tre) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 7 818,9 (shtatë mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë presje nëntë) m<sup>2</sup>;

g) Drejtorinë e ALUIZNI-t Vlorë (2), 8 (tetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 3 380 (tre mijë e treqind e tetëdhjetë) m<sup>2</sup>;

gj) Drejtorinë e ALUIZNI-t Sarandë, 17 (shtatëmbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 6 077,5 (gjashtë mijë e shtatëdhjetë e shtatë presje pesë) m<sup>2</sup>;

h) Drejtorinë e ALUIZNI-t Berat, 12 (dymbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 444,98 (dy mijë e katërqind e dyzet e katër presje nëntëdhjetë e tetë) m<sup>2</sup>;

i) Drejtorinë e ALUIZNI-t Shkodër, 106 (njëqind e gjashtë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 34 053, 75 (tridhjetë e katër mijë e pesëdhjetë e tre presje shtatëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup>;

j) Drejtorinë e ALUIZNI-t Fier (1), 22 (njëzet e dy) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 5 748,75 (pesë mijë e shtatëqind e dyzet e tetë presje shtatëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup>;

k) Drejtorinë e ALUIZNI-t Lushnjë, 13 (trembëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 813 (dy mijë e tetëqind e trembëdhjetë) m<sup>2</sup>;

l) Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan (1), 4 (katër) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 375,4 (treqind e shtatëdhjetë e pesë presje katër) m<sup>2</sup>;

ll) Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan (2), 13 (trembëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 4 234 (katër mijë e dyqind e tridhjetë e katër) m<sup>2</sup>;

m) Drejtorinë e ALUIZNI-t Gjirokastrë, 1 (një) parcelë ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme

trualli 500 (pesëqind) m<sup>2</sup>;

n) Drejtorinë e ALUIZNI-t Korçë, 24 (njëzet e katër) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 372,55 (dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy presje pesëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup>;

nj) Drejtorinë e ALUIZNI-t Pogradec, 11 (njëmbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 514,9 (dy mijë e pesëqind e katërbëdhjetë presje nëntë) m<sup>2</sup>;

o) Drejtorinë e ALUIZNI-t Lezhë, 6 (gjashtë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 972 (dy mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) m<sup>2</sup>;

p) Drejtorinë e ALUIZNI-t Kukës, 3 (tri) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 1 109,86 (një mijë e njëqind e nëntë presje tetëdhjetë e gjashtë) m<sup>2</sup>.

2. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**